



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/44
Datë: 16.11.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 04/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, i aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 01/02, datë 05.06.2020, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/23 të datës 13.08.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/33, i datës 28.09.2020, si në vijim:
 - 1.1. Mjetet e ndara sipas Vendimit të Qeverisë Nr.10/33, pika 1.4 në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, në nën-programin Ndërmarrësia me kod 49400, në shumë prej një milion euro (1,000,000,00 €), kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" rikthehen dhe transferohen në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
 - 1.2. Mjetet në shumë prej një milion euro (1,000,000 €) të rikthyera sipas pikës 1.1 të këtij vendimi, nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", transferohen në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me kod 213, në nën-programin Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike me kod 23300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
 - 1.3. Mjetet nga pika 1.2 e këtij vendimi alokohen dhe shfrytëzohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për mbështetjen e N.P "Trepça".
2. Të gjitha pikat tjera të Vendimit Nr. 10/33, të datës 28.09.2020 mbeten të pandryshuara.

3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë